



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

KARTË TEKNOLOGJIKE

Operacionet e gjelbëra në hardhi.

Operacionet e gjelbëra janë si vazhdim dhe plotësim i krasitjes dimërore.

Ç'kuptojmë me Operacione të gjelbëra?

Ndërhyrje gjatë periudhës vegetative në lastarë, sqetullorë, lulëri, gjethe, veshul, kokrra, etj.,

- **Qëllimet** që realizohen:
Korrigjohen gabimet e krasitjes dimërore, të dukshme dhe të pa dukshme, prandaj quhet krasitje plotësuese, korrigjuese e krasitjes dimërore.
- Rregullohet ekuilibri prodhim-vegetacion, ku mbahet një formë e caktuar e elementëve të vegetacionit që zhvillohen normalisht dhe sigurohet prodhimtaria e qëndrueshme në vite.
- Rriten treguesit sasiorë dhe cilësorë të prodhimit pa dëmtuar vegetacionin.
- Në hardhitë e reja mundësohet një zhvillim i mirë i lastarëve dhe sharmendave të reja ku formohen më mirë dhe më shpejt krahët dhe elementët e tjerë të kurorës.
- Lehtësohen punimet e mekanizuara dhe trajtimet kimike.
- **Principet bazë të operacioneve të gjelbëra**
Rritja dhe prodhimi në raport të drejtë me fuqinë e bimës (sipërfaqja asimiluese).
- Rritja e lastarëve në raport të zhdrejtë me numrin e tyre.
- Rritja e prodhimit (numri i madh i bistakëve), pakëson rritjen vegetative të hardhisë.

Klasifikimi i operacioneve të gjelbëra

Në bazë të organeve ku kryhen:

1. Në trung, krahë, çepa, sharmenda (t`harja)
2. Në lastarët e gjelbër (sqetullim, pincim, shkurtim maje, rrallim gjethe, unazim).
3. Në bistak (rrallim, ose reduktim i pjesëve të bistakut).
4. Në rrënjë (prerje e lastarëve nga n/shartesa, prerje e rrënjëve nga mbishartesa).

I. Eleminimi i lastarëve të tepërt (T`harrja)

Karte teknologjike

Realizon: Raport të drejtë midis numrit të lastarëve që lihen dhe fuqisë vegjetative të bimës (+ qëllime të tjera).

Llojet e lastarëve ku ndërhyet:

- a. Lastarë të dalë nga n/shartesa ose trungu nëntoksor.
- b. Lastarë të çelur në cung, ose pjesë druri të vjetër.
- c. Lastarë të dalë nga çepat e zëvendësimit.
- d. Lastarë të dalë nga sharmendat e prodhimit.

1. Parimi i heqjes së tyre: ruajtja e ekuilibrit pjesë ajrore - sistem rrënjor.
2. Për çdo 1 kg rrush jo më pak se 1 m² sipërfaqe gjethore.
3. Parimi i eliminimit të lastëve sipas natyrës prodhuese të kultivarëve, gjendjes së bimës, klimës, tokës dhe shërbimeve agroteknike.

Si veprohet

- ❖ Në hardhitë e reja heqja e lastarëve të tepërt ndikon pozitivisht në formimin e një trungu të trashë, të drejtë dhe të shëndetshëm.
- ❖ Kur nga një syth janë zhvilluar 2-3 lastarë, atëhere lihet vetëm lastari që ka dalë nga sythi kryesor, i zhvilluar mirë.
- ❖ Eliminohen binjakët, qofshin dhe me prodhim.
- ❖ Asnjëherë nuk hiqet lastari i dalë nga sythi i bazës.
- ❖ Në kultivarët me koeficient të lartë prodhimi hiqen të gjithë lastarët pa prodhim, por dhe me prodhim.
- ❖ Në kultivarët me bistak të mëdhenj, por të pakët, në çdo 2-3 lastarë prodhues, lihet një lastar pa prodhim.



Fig 1; 2 Rrallimi i lastarëve

Koha

Duhet të bëhet sapo të shfaqen shënjat e para të lulerive, para se të drunjzohen lastarët, deri në diferencimin e plotë të lulërive.

II. Pincimi dhe prerja e majave

- a) **Pincim** quhet heqja e masës së lastarit të ri së bashku me 1-2 gjethe të vogla.
- b) **Prerje e majave** quhet heqja e majës së lastarit të ri së bashku me 6-8 gjethe a më shumë.

Qëllimi

- i. Te hardhitë e reja shpejton dhënien e formës duke shtuar numrin e lastarëve.
- ii. Rrit lidhjen e kokrrave dhe veshulëve duke kaluar asimilatet drejt tyre nga frenimi 2 javor i prerjes.

1. Pincimi

- Nëse nuk pincohet maja e lastarit kryesor atëhere rritet shumë masa vegetative.

Teknika e pincimit: Këputje me 2-3 fletëza të vogla.

Rastet e përdorimit

- *Para lulëzimit* sjell zhvillim të madh të masës vegetative, duke ulur prodhimin.
- Nëse lulëritë vërehet se kalojnë në përdhredhëse atëhere pincohen majat, nëpërmjet së cilës ushqehen lulet dhe formimi i gameteve.



Fig. 3; 4 Prerja e majave

Koha kur bëhet pincimi: Çelja e 5-6 luleve të para.

2. Prerja e majave

Synon

- Ngadalësimin e shpenzimeve të ushqimit nga majat vegetative dhe uljen e transpiracionit.
- Redukton hijezimin e bistakëve të rrushit.
- Lehtëson kryerjen e shërbimeve.

Teknika e kryerjes

- Sipas natyrës së kultivarit, etj.,

Rastet e përdorimit

- *Para lulëzimit* sjell sjell rritjen e % së luleve të plenuara, rrit numurin e kokrrave të formuara, formon veshule të mbushur mirë, prodhim të lartë dhe me pjekje të vonë.
- *Pas lulëzimit* sjell rritje të kokrrave dhe veshulëve , duke shpërndarë normalisht në bimë asimilatet me një proces normal të diferencimit të lulerisë së parë qysh në fund të muajit Maj.
- Nuk rekomandohet prerja e majave të lastarit kryesor kur hardhitë janë të dobëta.
- Në kohë thatësire dhe pa ujitje, prerja e majave bëhet më herët duke hequr 6-7 gjethe së bashku me majën e rritjes.

Koha: 20-30 Qershor.

III. Heqja e sqetullorëve (Sqetullimi)

- Heqja e lastarëve të dalë në sqetull të gjetheve nga sythat verorë.
- Roli ushqyes i tyre, por dhe konsumues.

Teknika e kryerjes

- **Hiqen** tërësisht në zonën **rreth bistakut dhe pincohen në 4-6-7 gjethe** në lastarët e sipërm kur nuk pengojnë trajtimet kimike.
- **Nuk hiqen** as në rastet e **lastarit që do të shërbejë si sharmend prodhimi** vitin pasardhës (ndihmojnë në diferencimin e sythit dhe eliminohet çelja e sythit dimëror).
- Çdo lastarë duhet të ketë 10-15 gjethe për veshul.

Shfrytëzimi për zëvendësimin ose rinovimin e pjesëve të demtuara.

- Në kohë thatësire pa ujitje ku lastarët kryesorë janë të dobët, priten majat e tyre duke lënë sqetullorët me 4-5 gjethe,
- Në rastet e dëmtimit të lastarëve nga breshëri, lastarët sqetullorë shfrytëzohen për prodhim të dytë dhe për të rikrijuar pjesët e demtuara.
- Në këtë rast lastarët sqetullorë për prodhim të dytë, lihen me 1-2 veshulë/lastar, pjekja ndodh 3 javë pas pjekjes kryesore.

Koha: Kur sqetullori të ketë nxjerrë 4-6 gjethe.

IV. Unazimi i lastarëve prodhues**Qëllimi**

- Bëhet për të rritur cilësinë e kokrrës te rrushi i tavolinës,
- Shpejton pjekjen 10-12 ditë si dhe rrit prodhimin 25-30 %.

Teknika

Kryhet duke hequr me kujdes lëvoren deri në shtresën e jatshme të drurit, me anë të një prerje në formë unaze me gjerësi 3mm - 4 mm. Asimilatet kalojnë në drejtim të veshulit dhe kokrrave dhe jo në cung dhe rrënjë.

V. Heqja e gjetheve të fundit të lastarëve (Rrallimi i gjetheve)

Operacion i diktuar nga:

- Dendësia e masës vegetative që pengon ndriçimin, ajrimin dhe shton rrezikun e infeksioneve parazitare (vrug, hi dhe kalbëzim).
- Praktika e gabuar e momentit të heqjes (në fazat e para të rritjes së lastarit kur gjetnja mund të krahasohet me stomakun).

Qëllimi

- Rritet ndriçimi,
- Ajrosen veshulët,
- Pakësont infeksionin nga sëmundjet,
- Rritet sasia dhe cilësia e prodhimit.

Teknika kryhet ne tre nivele:

- Hiqen 2-3 gjetthet e fundit , deri te veshuli i parë.
- Hiqen gjetthet deri te veshuli i fundit, nuk hiqet gjetnja përballë veshulit
- Hiqet edhe gjetnja përballë veshulit të fundit së bashku me gjetthen e parë të dalë mbi veshul.

Kjo masë aplikohet në zonat ku ndriçimi nuk është më i lartë se 40–60 mijë lux.

Në zonat me ndriçim të lartë diellor hiqen vetëm 2-3 gjetthet e fundit.

Ndriçimi dhe temperatura normale konsiderohen kur janë përkatësisht: 20-60 mijë lux dhe 25-30°C.

Koha

- Heqja e gjetheve fillon afersisht 3 javë pas lulëzimit deri në fillim të pjekjes së rrushit.



Fig. 5 cv. Shesh i Bardhë

VI. Rrallimi i kokrrave dhe veshulëve

Qëllimi

- ✓ Të rritet madhësia e kokrrave,
- ✓ Të rritet cilësia e prodhimit,
- ✓ Të rritet % e sheqerit (e ëmbëlsimit),
- ✓ Të rritet intensiteti i ngjyrosjes së kokrrave,

- ✓ Cilësitë tregtare të prodhimit.

Teknika e kryerjes:

- Bëhet kryesisht te kultivarët e rrushit të tavolinës me potencial të lartë prodhimi.
- Nuk bëhet rrallimi i kokrrave dhe veshulit te kultivarët/bimët me potencial të ulët.

Rrallohen veshulet:

- a) e vegjël jo karakteristike, nuk kanë shumë kokrra të lidhura,
- b) shumë i ngjeshur me kokrra të vogla,
- c) afër tokës,
- d) e prekur nga sëmundjet,
- e) e hijezuar, etj.,

Hiqen deri në 30 % e veshulëve.



Fig. 6 Bimë që kërkojnë rrallim veshulësh



Fig. 7 Kultivari Pulës pas rrallimit të veshulëve

Koha

- Rrallimi i kokrrave në veshul bëhet kur ka përfunduar rënia natyrale e luleve, kokrrave të pa pllenuara dhe kokrrave të zhvilluara dobët. në kohën e lidhjes së kokrrës, kur bistaku dallohet plotësisht.
- Fillon 14-15 ditë mbas mbarimit të lulëzimit.
- Bëhet 15-20 ditë pas pllenimit, kur kryhet me spërkatje, me Giberelinë (acid giberelik)

Mënyra

- Me dorë më e mira,
- Me preparate, nëpërmjet spërkatjeve gjatë fazës së lulëzimit të plotë me fitohormone që shkaktojnë rrallimin e deri 30-40 % të luleve (ku largohen mbi numrin e planifikuar që kërkojmë).